

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202002027/3

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandim në lidhje me shoqërimin e Shtetasit z. Kastriot Çipi në Komisarariatit e Policisë nr.1 Tiranë, në datë 15.05.2020

Drejtuar: Z. Oligert TORBA
Shef i Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë
TIRANË

Për dijëni: Drejtues i parë Rebani JAUPI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Te nderuar .

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një verifikim në Komisarariatit e Policisë Nr.1, Tiranë në datën 15.05.2020 pas regjistrimit të një ankese në zyrën e pritjes së qytetarëve për shoqërimin e disa shtetasve, ndër to edhe z. Kastriot Çipi, nga strukturat e Komisarariatit të Policisë nr.1, gjatë një aktiviteti që po zhvillohej në sheshin "Skënderbej", Tiranë. Në këtë kuadër, institucioni ynë ka filluar menjëherë hetimin administrativ për verifikimin e veprimeve për shoqërimin e tij.

Së pari, përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit kanë zhvilluar takim me z. Çipi i cili ndodhej i shoqëruar brenda ambienteve të komisarariatit nr.1 Tiranë ku u intervistua dhe u mor deklarata e tij.

Shtetasi Kastriot Çipi deklaroi se, duke ushtruar profesionin e tij të gazetarit, ishte në detyrë duke filmuar momentin e shoqërimit të avokatit Altin Goxhaj, në momentin kur edhe ai është shoqëruar nga tre punonjës policie, njëri prej tyre pa numër identifikimi, pranë Xhamisë në sheshin "Skënderbej", Tiranë. Po kështu, ai deklaroi se vuan nga probleme shëndetësore të hipertensionit, dhe nuk i janë siguruar ilaçet e nevojshme e as nuk i është lejuar takimi me personelin shëndetësor, nga trupa e shoqërimit.

Z. Çipi deklaroi se nuk i janë sqaruar arsyet e shoqërimit, nuk i është lejuar të kontaktojë me Avokatin e Popullit, nuk i është vënë në dispozicion karta e të drejtave, dhe as nuk i është dhënë mundësia për të kontaktuar me një avokat mbrojtës apo me familjarët.

Nga të dhënat e regjistrimit të personave të shoqëruar rezulton se shoqërimi është realizuar përkatësisht në oraret 12:40 dhe 12:45. Theksojmë se deri në momentin e kryerjes së verifikimit nga Avokati i Popullit, në orën 15:00 nuk ishte kryer asnjë nga procedurat standarde të cilat lidhen me shoqërimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ashtu sikurse i kemi rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë edhe më herët , vlerësojmë se në përmbushje të standarteve më të mira të të drejtave të njeriut, që personave të shoqëruar në ambientet e organeve të policisë t'u komunikohet në formë shkresore karta e të drejtave, duke u shoqëruar dhe me nënshkrimet e personave përkatës si dhe orën e saktë të komunikimit e cila duhet të bëhet në momentin e vendosjes së personit nën mbikqyrje policore.

Së dyti, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë zhvilluar takim me drejtuesin në detyrë të Komisarariatit nr.1, të cilit iu prezantuan problematikat e konstatuara në procedurën e shoqërimit.

Në prezencë të përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, ai thirri për ballafaqim personin e shoqëruar z. Kastriot Çipi, të cilin e pyeti mbi gjendjen shëndetësore, nëse problemin shëndetësor e kishte bërë me dije tek trupat që e kishin shoqëruar, si dhe u pyet nëse vërtet ushtronte profesionin e gazetarit, dhe nëse kishte një dokument që e vërtetonte këtë fakt. Z. Çipi pohoi se ushtron profesionin e gazetarit, fakt për të cilin vendosi në dispozicion edhe një dokument provues, dhe u shpreh se ky i fundit nuk ishte marrë në konsideratë nga trupa e shoqërimit, si edhe deklaroi se është hipertonic, dhe i është refuzuar matja e tensionit dhe dhënia e mjekimit. Drejtuesi i komisarariatit në detyrë udhëzoi personelin përkatës të kontaktojë familjarët e personit të shoqëruar, të merret deklarimi nga OPGJ sa më shpejt dhe personi të lihet sa më shpejt i lirë.

Pas largimit të personit të shoqëruar, drejtuesi i Komisarariatit në detyrë u shpreh se aksioni policor për shoqërimin e personave, është kryer në zbatim të aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19".

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vlerëson se shoqërimi në rastin e z. Kastriot Çipi gjatë kryerjes së detyrës të gazetarit e ka barazuar statusin e raportuesit të ngjarjes me atë të organizuesit pjesëmarrës.

Kufizimi i të drejtës së qytetarëve për t'u mbledhur në kërkim të të drejtave të tyre, pra për t'u organizuar në tubime, si edhe të gjitha masat e tjera të kufizimit të lirive dhe të drejtave duhet t'i nënshtrohen parimit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, parime të cilat duhet të zbatohen jo vetëm në nivel vendimarrje politikash (pra organet që nxjerrin udhëzimet përkatëse në gjendje emergjence shëndetësore apo gjendje të fatkeqësisë natyrore) por edhe nga organet që i zbatojnë këto udhëzime. Edhe nëse mund të konsiderojmë se në momentin e parë ndalimi i tubimeve ishte masë proporcionale për një interes më të lartë publik që është ai i garatimit të jetës dhe shëndetit , ndalimi absolut nuk mund të konsiderohet më proporcional ndërsa masat kufizuese po lehtësohen. Në çdo rast, duhet që të rishikohet domosdoshmërisht mënyra e zbatimit të kufizimit, apo e ndalimit në datën në të cilën është shoqëruar gazetari Çipi.

Në këtë kuptim, një qasje korrekte edhe në respektim të Kushtetutës e të instrumentave ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut do të ishte rishikimi i kësaj mase, duke lejuar ushtrimin e të drejtës për të tubuar, nën garancinë e rregullave strikte të përcaktuara nga autoritetet, ashtu, siç në fakt, po veprohet për shumë masa të tjera kufizuese.

Në vijim të këtij detyrimi dhe për t'u krijuar lehtësi shtetasve për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, por edhe për të unifikuar qëndrimin e organeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe atyre gjyqësore në të tilla raste, strukturat kompetente shtetërore duhet të përmirësojnë aktet normative që rregullojnë lirinë e tubimit, me qëllim që ajo të ushtrohet edhe në rastet e pandemive apo shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Gjatë procesit të përgatitjes së këtyre akteve të mbahen parasysh vendi se ku do të

zhvillohet tubimi, i mbyllur apo i hapur, sipërfaqja e tij, numri i pjesëmarrësve, masat mbrojtëse ndaj përhapjes së infeksionit, parimi i rëndësishëm i proporcionalitetit, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdimisht në rekomandimet që i ka adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka kërkuar respektimin nga strukturat e këtij organi të lirisë së tubimit, të lëvizjes së lirë, parimit të proporcionalitetit, të drejtës së informimit dhe të ofrimit të shërbimit dhe të lehtësimeve të nevojshme qytetarëve nga këto organe. Konkretisht, i referohemi rekomandimeve si më poshtë:

1. Rekomandimi dërguar DPP Shtetit për: 1. “Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e modelarëve tip, si “Njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike” dhe “Njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin e tubimit urgjent në sheshe ose vendkalime publike” nga subjektet njoftuese, publikimin e tij në Eëbsite e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim që të jetë i aksesueshëm për shtetasit dhe të krijojë mundësinë e aplikimit on-line prej tyre. 2. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e modelarëve tip, si “Vendim administrativ për komunikim me organizatorin ose drejtuesin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij”, sipas nenit 6/1/a të ligjit “Për Tubimet” dhe “Vendim administrativ për ndalimin e zhvillimit të tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo për përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit”, sipas nenit 8 të këtij ligji”.
2. Rekomandimi dërguar DPP Shtetit për: “Marrjen e masave për një qendrim të drejtë dhe zbatim korrekt nga Policia e Shtetit të ligjit nr.8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, për të mos ndaluar apo kufizuar organizimin apo pjesëmarrjen e qytetarëve në tubimet paqësore me qëllim, respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si atë të tubimit ashtu edhe atë të lëvizjes së lirë”.
3. Rekomandimi dërguar DPP Shtetit për: “1. Zbatimin e parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gazi lotsjellës nga punonjës të policisë; 2. Analizimin e rasteve nga strukturat përgjegjëse për përdorimin e gazit lotsjellës dhe në Drejtoritë Vendore të Policisë”.

Së treti, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit siguruan kopje të regjistrit të personave të shoqëruar, ku janë evidentuar të dhënat personale të personave të shoqëruar, si edhe detajet lidhur me vendin, orën e shoqërimit, etj.

Nisur nga nevoja për të përmbushur një monitorim më gjithpërfshirës të institucioneve ku liria e personave është e kufizuar, ku dhe probabiliteti për shkelje është më i lartë, janë paraparë të rëndësishme për zbatim edhe dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)” miratuar me Ligjin Nr. 9094, dt. 03.07.2003. Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektiveve në institucionet e mësipërme dhe garantojnë një aktivitet konform standardeve kombëtare në këtë drejtim.

Po kështu, Këshilli i të Drejtave të Njeriut me Rezolutën 31/31 të vitit 2016 i inkurajoi shtetet të mbajnë azhurnuar regjistrat zyrtarë të personave në mbikqyrje policore që, përmbajnë të paktën informacione për:

- a) arsyet e arrestimit
- b) kohën e arrestimit dhe dërgimit të personit të arrestuar në një vend ndalimi, si dhe paraqitjen e parë para një organi gjyqësor ose autoriteti tjetër
- c) identitetin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fjalë, dhe
- d) informacione të sakta në lidhje me vendin e ndalimit.

Këshilli për të Drejtat e Njeriut gjithashtu rekomandoi që Shtetet duhet t'ia komunikojnë këto të dhëna personit të shoqëruar ose mbrojtësit të tij.

Inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në Institucionet e Policisë së Shtetit, ka pasur si objektiv të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi situatën e të drejtave të njeriut në këto organe, të parandalojë shkeljet, si dhe të artikulojë një qëndrim realist zyrtar mbi situatën në terren.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda Komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vlerëson të sjellë në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave të shoqëruar, që në orët e para të shoqërimit. Një person i shoqëruar nga policia është në një situatë të cënueshmërisë së veçantë, pasi personi është plotësisht në duart e agjentëve të zbatimit të ligjit. Ky çekuilibër pushteti krijon një situatë rreziku ku mund të ndodhin abuzime dhe tortura. Tortura është një nga shkeljet më serioze të thelbësore të një personi që i shkelen të drejtat. Mund të shkatërrojë dinjitetin, trupin dhe mendjen e një personi dhe të ketë larg efektet në shoqëri. Megjithë ndalimin e tij absolut sipas ligjit. Abuzimet nga policia mund të ndodhin për shumë arsye, sepse përdorimi në përputhje me parimin e proporcionalitetit nuk është një detyrë e lehtë. Shkeljet e të drejtave të njeriut mund të vijnë nga një vlerësim i gabuar i një situatë të caktuar. Abuzimet mund të ndodhin edhe kur punonjësit e veçantë të policisë përfitojnë nga fuqia e tyre duke ushtruar forcë të tepruar për të frikësuar, marrë informacionin ose për arsye të tjera. Mund të jetë gjithashtu - dhe kjo është më sfiduese situata për monitoruesit që kërkojnë të adresojnë torturat ose keqtrajtimet e tjera sepse ekziston një kulturë e pandëshkueshmërisë në një kontekst të caktuar: në raste të tilla, oficerët e policisë që kryejnë shkelje të të drejtave të njeriut e dinë që do ta bëjnë këtë të mos ndiqen penalisht ose të disiplinohen. Përveç përdorimit të forcës, fushat kryesore të rrezikut përfshijnë mënyrën e kufizimit që janë përdorur, si kryhen kërkimet dhe nëse janë diskriminuese. Rreziqet e abuzimit në paraburgim policor janë veçanërisht të larta gjatë disa viteve të para orë paraburgimi, kjo është koha kur të paraburgosurit janë më të rrezikuar dhe kur zyrtarët janë nën presionin më të madh për të siguruar informacione prej tyre. Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet.

Masat mbrojtëse kryesore përfshijnë:

- dhënia e informacionit për të shoqëruarit për të drejtat e tyre,
- sigurimin e aksesit te një avokat,
- duke njoftuar anëtarët e familjes dhe / ose një palë të tretë për personin
- dhënia e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar të jetë e mundur pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.

Kështu, përveç ndihmës për të parandaluar abuzimet, masat mbrojtëse të integruara nuk duhet të zvogëlohen por duhet të jenë sa më korrekte dhe të ushtruara në kohë.

Nga monitorimi i ambienteve të Komisariateve shpesh herë MKPT ka konstatuar se të drejtat e personave të shoqëruar nuk zbatohen në mënyrë të rregullt përgjatë orëve të para të shoqërimit në komisariate. Problematikat e konstatuara janë:

- Persona të shoqëruar/ ndaluar nga policia shpesh herë në orët e para të shoqërimit, nuk kanë pasur qasje në avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasë me të dhe të

jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje) . Qasja te një avokat shërben për qëllime të shumta plotësuese për personin e ndaluar, përfshirë përgatitjen e mbrojtjes dhe ruajtjen e procesit të rregullt ligjor.

- Persona të shoqëruar /ndaluar nga punonjësit e policisë nënshkruajnë deklaratën që vërteton se morën një kopje të fletës së fakteve me të drejtat e tyre në përfundim të procesit të marrjes në pyetje në organin e policisë. CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse përgjatë vitit 2018- të se personat e shoqëruar /ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/proceduriale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë. Sipas gjetjeve të MKPT, fleta shpjeguese me të drejtat e personave të ndaluar u jepet atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje. Ndërsa në rastin konkret ajo nuk i ishte dhënë anktuesit deri në momentin në të cilin u zhvillua takimi me të prej përfaqësuesve të Avokatit të Popullit.

- Personat e shoqëruar/ndaluar nga policia është konstatuar se kanë pasur vonesa në qasjen në kujdesin shëndetësor dhe kujdesin mjekësor duke u bazuar në dispozita të përcaktuara në manual/procedurë për trajtimin dhe sigurimin me rigorozitet për kryerjen e ekzaminimit fillestar.

- Libri i ankesë/kërkesave ato shpesh herë është i pa plotësuar. Ligji Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, neni 115 përcakton se çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë, kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cenohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t’u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore. 2. Personi, i cili shoqërohet nga policia sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës në çdo kohë. 3. Punonjësi i policisë, pasi e ka regjistruar kërkesën/ankesën, e dokumenton në regjistrin përkatës dhe është i detyruar ta dërgojë menjëherë atë në institucionin të cilit i adresohet ankesa. 4. Për kërkesat/ankesat që u drejtohen drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari, i ndaluari apo i arrestuari, përgjigjja i jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së tyre.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës duke ju referuar qëllimit të inspektimeve, verifikimit dhe respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, Programit të Punës të CPT Nr. 5949, datë 09.07.2019 “Për përmbushjen e rekomandimet e raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit Evropian Kundër Torturës (CPT) për përmirësimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit ”, ka detyrimin ligjor të ndërhyjë për zgjidhjen e problematikave të konstatuara.

Dëshirojmë të theksojmë gjithashtu se gjatë verifikimit të kryer në ambjentet e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, u konstatua se respektimi i masave të detyrueshme për mbrojtjen nga përhapja e sëmundjes infektive COVID-19, nuk i ishte në nivele të kënaqshme . E përmendim këtë fakt, pasi shoqërimi i z. Çipi në Komisarariat ka ardhur si rezultat i aksionit për shpërndarjen e një aktiviteti, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, ndërkohë që vetë masat mbrojtëse dhe kushtet në ambientet e komisarariatit ku personi shoqërohet nuk janë të tilla që të japin garanci për mbrojtjen e shëndetit të tyre.

Do të mjaftonte vetem ky fakt për të konstatuar se përveçse i paligjshëm, shoqërimi i tij për shkak se ishte gazetar, qoftë edhe gazetar i rrjeshtuar kundër masave të marra nga qeveria në kuader të gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të COVID-19 nuk mund të kryhej edhe sepse ishte jo proporcional. Shëndeti i tij është vënë në një rrezik më të madh duke u shoqëruar përsa gjatë shoqërimit dhe brenda Komisarariatit të policisë nuk rezultojnë të jenë zbatuar masat anitcovid, për pajisje me maska dhe ruajtje distance me persona të tjerë. Jeta e qytetarit Çipi nuk mund të vihej në një rrezik më të madh se rreziku që qeveria ka si qëllim të parandalojë duke marrë masën e ndalimit të grumbullimeve masive nëpërmjet aktit normativ të sipërcituar.

Sa më lart, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDIMË:

1. Evidentimin e rastit dhe nxerrjen e përgjegjësive konkrete administrative për shkeljet e konstatuara nga ana e punonjësve të Komisarariatit nr.1 në shoqërimin e gazetarit Çipi në ambientet e komisarariatit nr. 1 që lidhen konkretisht me:
 - Shoqërimin e gazetarit për shkak të detyrës;
 - Mosofrimin e shërbimit të nevojshëm mjekësor;
 - Mos vendosjen në dispozicion të kartës së të drejtave;
 - Moscaktimin e komunikimit me familjarët dhe as të një avokati mbrojtës;
2. Marrjen e masave të menjëhershme për të mos shoqëruar gazetarë apo persona të tretë të cilët janë në ushtrimin e detyrës së tyre për informimin e publikut në lidhje me organizmin e protestave apo ngjarjeve të tjera me interes për publikun.
3. Marrjen e masave për të mundësuar qasje të menjëhershme për avokat që në momentin e shoqërimit apo ndalimit të personave në organet e policisë së shtetit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për të mundësuar qasje të menjëhershme për mjek që në orët e para të privimit të lirisë ndaj personave në organet e policisë së shtetit.
5. Marrjen e masave të nevojshme për personat e shoqëruar /ndaluar të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë, dhe vënia në dispozicion kartën e të drejtave për njohjen me to.
6. Marrjen e masave për plotësimin dhe saktësimin në regjistër të kohës së privimit të lirisë nga punonjësi i policisë.
7. Marrjen e masave për plotësimin e protokolleve të detyrueshme anticovid për të mos rrezikuar shëndetin e të shoqëruarve brenda ambienteve të Komisariateve.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,